



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 217

Tiranë – E mërkurë, 16 dhjetor 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 9340, datë 4.12.2015	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 14361
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 964, datë 2.12.2015	Për kalimin e helikopterëve e të pajisjeve të tyre, nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Shëndetësisë te Ministria e Mbrojtjes..... 14361
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 992, datë 9.12.2015	Për disa ndryshime në vendimin nr.54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar..... 14362
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 91, datë 2.12.2015	Për disa ndryshime në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit” 14363
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 130, datë 31.10.2015	Për certifikimin paraprak të shoqërisë TAP AG si operator i pavarur i transmetimit të gazit natyror..... 14366
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 136, datë 26.11.2015	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e një ndryshimi në rregullat e tregut shqiptar të energjisë elektrike..... 14367
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 137, datë 26.11.2015	Mbi fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Phoenix Petroleum” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror..... 14368
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 138, datë 26.11.2015	Për licencimin e shoqërisë “HP Ujaniku Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Ujanik 2”, me fuqi të instaluar 2500 kW..... 14369
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 139, datë 26.11.2015	Për licencimin e shoqërisë “HP Ujaniku Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike..... 14369
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 140, datë 26.11.2015	Për licencimin e shoqërisë “Energjia D.O.O. Veternik” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike..... 14370

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 141, datë 26.11.2015	Për licencimin e shoqërisë “Energjia D.O.O. Veternik” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.....	14370
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 142, datë 26.11.2015	Për licencimin e shoqërisë “C & S Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Rapun 3 & 4”, me fuqi të instaluar 8857 kW.....	14371
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 143, datë 26.11.2015	Për licencimin e shoqërisë “C & S Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	14372
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 145, datë 26.11.2015	Për fillimin e procedurave për rinovimin e licencës së shoqërisë GSA sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 57, datë 22.6.2011.....	14372
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 146, datë 26.11.2015	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Liria Energji” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Shpella Poshtë 2”, me fuqi të instaluar 2300 kW.....	14373
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 147, datë 26.11.2015	Mbi fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Liria Energji” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	14374
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 148, datë 26.11.2015	Mbi fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Liria Energji” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike...	14374
	Vendim për shpalljen të zhdukur të shtetasit Florenc Nito.....	14375
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur dhe të vdekur të shtetasit Mehmet Hodaj.....	14375

**DEKRET**

Nr. 9340, datë 4.12.2015

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93, të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Valbona Hamdi Dashllari (Dyli)
2. Aida Minella Bitri
3. Shpresa Gani Xhixha
4. Enkelejd Sali Shehu
5. Mehmet Durim Tusha
6. Sofia Eloise Mehmet Tusha
7. Valmira Pazait Lamaj (Dalipaj)
8. Ujvara Hysen Pepaj
9. Gramoz Hysen Pepaj
10. Vjola Spiro Duri
11. Diana Vehbi Kuçi
12. Sokol Kulla Kulla
13. Edmond Bilal Haxhiraj
14. Zamira Qamil Haxhiraj (Dafku)
15. Ilir Hajri Dollani
16. Dashamir Ramadan Çokaj
17. Bekim Petrit Haxhijaj
18. Ermira Hamit Leskaj
19. Sonila Vasillaq Vangjel
20. Lorin Artan Canaj
21. Vladimir Martin Barth (Ndreka)
22. Rume Vojin Zlatičanin (Pambuku)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM

Nr. 964, datë 2.12.2015

PËR KALIMIN E HELIKOPTERËVE E TË PAJISJEVE TË TYRE, NGA MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME DHE MINISTRIA E SHËNDETËSISË TE MINISTRIA E MBROJTJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, ministrit të Punëve të Brendshme dhe ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Helikopterët dhe pajisjet e tyre, në administrim të Ministrisë së Punëve të Brendshme (Policisë së Shtetit) dhe Ministrisë së Shëndetësisë, të kalojnë, pa shpërblim, në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas anekseve nr. 1 (Ministria e Punëve të Brendshme) dhe nr. 2 (Ministria e Shëndetësisë), që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Helikopterët dhe pajisjet të dorëzohen në gjendjen aktuale që ato ndodhen.

3. Dorëzimi dhe marrja në dorëzim bëhen me komisione përkatësisht të Ministrisë së Punëve të Brendshme (Policisë së Shtetit), Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Komandimi i helikopterëve për qëllimet e Ministrisë së Punëve të Brendshme (Policisë së Shtetit) dhe të Ministrisë së Shëndetësisë do të bëhet nga personat e autorizuar, përkatësisht, ministri i Punëve të Brendshme dhe ministri i Shëndetësisë.

5. Në rast të pamundësisë së përdorimit të helikopterëve, që shërbejnë për Ministrinë e Punëve të Brendshme (Policinë e Shtetit) dhe Ministrinë e Shëndetësisë, do të përdoren helikopterët e Ministrisë së Mbrojtjes.

6. Personeli prej 11 vetash, i angazhuar në Komisaratin Special të Helikopterëve, në përbërje të RENEA-s, i zbritet numrit të përgjithshëm të punonjësve të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe i shtohet numrit të përgjithshëm të punonjësve të Ministrisë së Mbrojtjes.



7. Personeli prej 11 vetash, i angazhuar në Njësinë e Transportit Mjekësor me Helikopterë, të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore të Ministrisë së Shëndetësisë, i zbritet numrit të përgjithshëm të punonjësve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe i shtohet numrit të përgjithshëm të punonjësve të Ministrisë së Mbrojtjes.

8. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Punëve të Brendshme dhe ministri i Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI NR. 1
HELIKOPTERËT E MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME

Nr.	Marka	Tipi	Viti i prodhimit	Shteti prodhues	Statusi aktual
1	Mi	8	1992	Rusi	Në riparim në Bullgari, deri në fund të këtij muaji
2	AS	350B	1985	Francë	Në gatishmëri – në punë
3	AS	350B	1985	Francë	Jashtë gatishmëri - në pritje për t'u riparuar
4	BO	105E	1981	Gjermani	Jashtë gatishmëri - në ruajtje
5	BO	105E	1981	Gjermani	Jashtë gatishmëri - në ruajtje

ANEKSI NR. 2
HELIKOPTERËT E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË

Tipi i helikopterëve	Nr. i regjistrimit	Marka	Shteti prodhues	Viti i prodhimit	Statusi/gatishmëri
ALO-3/SA 319B	2139	ZA-XRJ	Francë	1974	jo në gatishmëri
ALO-3/SA 319B	2299	ZA-XFM	Francë	1976	jo në gatishmëri
ALO-3/SA 319B	2378	ZA-XHZ	Francë	1979	gatishmëri
ALO-3/SA 319B	1995	ZA-XHP	Francë	1978	gatishmëri
BO-105 E-4	5058	ZA-XCL	Gjermani	1982	gatishmëri
BO-105 E-4	5011	ZA-ZLE	Gjermani	1980	gatishmëri
EC-135/P2+	1072	ZA-XHB	Gjermani/Spanjë	2013	gatishmëri

VENDIM
Nr. 992, datë 9.12.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.54, DATË 5.2.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, PROCEDURËS DHE MËNYRËS SË DHËNIES ME QIRA, ENFITEOZË APO KONTRATA TË TJERA TË PASURISË SHTETËRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të aktit normativ nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, të miratuar me ligjin nr.9967, datë 24.7.2008, dhe të neneve 784 e 801, të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me Faqe|14362

propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “f”, e pikës 5, të kreut I, “Pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiteozë, kriteret e konkurrimit, e drejta, kompetencat dhe afatet”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“f) Shtesa në kontratë ose kontrata e re, në rastet kur në administrim të shoqërive, ndërmarrjeve shtetërore apo institucioneve shtetërore kanë mbetur pasuri shtetërore truall, me sipërfaqe jo më shumë se 1 000 (një mijë) m², që janë të pashfrytëzueshme për shkak se janë të rrethuara ose në kufi nga i njëjti pronar ose pronarë të tjerë dhe kur kjo sipërfaqe kërkohet të merret me qira nga i njëjti pronar.”.



2. Tabela A, bashkëlidhur vendimit në fuqi, zëvendësohet me tabelën A, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

TABELA A
TARIFAT DYSHEME TË QIRASË MUJORE PËR NDËRTESAT SIPAS QARQEVE

NR.	QARKU	SPECIFIKIMI TERRITORIAL	TARIFA DYSHEME
1.	Tiranë	Në qytetin e Tiranës.	300
		Jashtë qytetit të Tiranës.	150
2.	Berat	Në qytetin e Beratit.	100
		Jashtë qytetit të Beratit	50
3.	Dibër	Në qytetin e Peshkopisë	75
		Jashtë qytetit të Peshkopisë	50
4.	Durrës	Në qytetin e Durrësit	200
		Jashtë qytetit të Durrësit	150
5.	Elbasan	Në qytetin e Elbasanit	150
		Jashtë qytetit të Elbasanit	75
6.	Fier	Në qytetin e Fierit	150
		Jashtë qytetit të Fierit	100
7.	Gjirokastrë	Në qytetin e Gjirokastrës	75
		Jashtë qytetit të Gjirokastrës	50
8.	Korçë	Në qytetin e Korçës	150
		Jashtë qytetit të Korçës	75
9.	Kukës	Në qytetin e Kukësit	75
		Jashtë qytetit të Kukësit	50
10.	Lezhë	Në qytetin e Lezhës	150
		Jashtë qytetit të Lezhës	100
11.	Shkodër	Në qytetin e Shkodrës	150
		Jashtë qytetit të Shkodrës	100
12.	Vlorë	Në qytetin e Vlorës	200
		Jashtë qytetit të Vlorës	100

VENDIM
Nr. 91, datë 2.12.2015

**PËR DISA NDRYSHIME NË
RREGULLOREN “PËR RAPORTIN E
MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 58, shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, nenit 59, pikat 2 dhe 3, dhe të nenit 60, pika 2, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Departamentit të Stabilitetit Financiar dhe Statistikave, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, miratuar me

vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 48, datë 31.07.2013, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Përmbajtja e nenit 6 ndryshon si më poshtë vijon:

“1. Bankat llogarisin ekspozimet e ponderuara me rrezikun, si shumë e elementeve të mëposhtme:

a) zërave të ekspozimeve dhe ekspozimeve të mundshme, të ponderuar me rrezikun e kredisë dhe rrezikun e kredisë së kundërpartisë, të llogaritura sipas metodës standarde, të përcaktuar respektivisht në kreun III dhe në kreun VI të kësaj rregulloreje;

b) kërkesës për kapital për rrezikun e tregut, të llogaritur sipas kërkesave të përcaktuara në kreun VII të kësaj rregulloreje, të shumëzuara me 12.5;

c) kërkesës për kapital për rrezikun operacional, të llogaritur sipas metodës së treguesit të thjeshtë ose sipas metodës standarde, të përcaktuara në kreun VIII të kësaj rregulloreje, të shumëzuara me 12.5.

2. Pavarësisht përcaktimeve në paragrafin 1 të këtij neni, banka rregullon totalin e aktiveve dhe të zërave jashtë bilancit të ponderuar me rrezikun, siç përcaktohet më poshtë:



a) duke e shtuar me vlerën e rritjes që rezultojnë në krabasim me muajin mars 2013, të klasave në aktiv të bilancit “veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare” dhe “veprime në valutë me tituj” me jorezidentët, pasi të jetë zbritur vlera e shtuar e detyrimeve ndaj jorezidentëve në valutë, që i përkasin të njëjtave klasa në atë periudhë raportuese;

b) për vitin 2016:

i) për periudhën 1 janar – 30 qershor 2016, duke e pakësuar me vlerën që rezultojnë nga një prej dy llogaritjeve të mëposhtme:

1) vlerën e rritjes së tepriçës bruto të kredisë për klientët¹, të akorduar brenda vendit, në periudhën e raportimit, e kthyer në bazë vjetore, në krabasim me muajin dhjetor 2015, në rast se kjo rritje është më e madhe se 4 (katër) % dhe më e vogël ose e barabartë me 10 (dhjetë) %;

2) vlerën 10 (dhjetë) % të tepriçës bruto të kredisë për klientët të akorduar brenda vendit, në krabasim me muajin dhjetor 2015, në rast se rritja në periudhën e raportimit, e kthyer në bazë vjetore, është më e madhe se 10 (dhjetë) %;

ii) për periudhën 1 korrik – 31 dhjetor 2016, duke e pakësuar me gjysmën e vlerës që rezultojnë nga një prej dy llogaritjeve të mëposhtme:

1) vlerën e rritjes së tepriçës bruto të kredisë për klientët², të akorduar brenda vendit, në periudhën e raportimit, e kthyer në bazë vjetore, në krabasim me muajin dhjetor 2015, në rast se kjo rritje është më e madhe se 4 (katër) % dhe më e vogël ose e barabartë me 10 (dhjetë) %;

2) vlerën 10 (dhjetë) % të tepriçës bruto të kredisë për klientët të akorduar brenda vendit, në krabasim me muajin dhjetor 2015, në rast se rritja në periudhën e raportimit, e kthyer në bazë vjetore, është më e madhe se 10 (dhjetë) %.

3. Për llogaritjet sipas përcaktimeve të shkronjave “a” dhe “b”, të paragrafit 2, bëhen sipas formularit 1 dhe 2, aneksi 8.

4. Shkronjat “a” dhe “b”, të paragrafit 2, të këtij neni, janë në fuqi deri në fund të vitit kalendarik 2016.

5. Në përfundim të afatit të përcaktuar në pikën 4 të këtij neni, banka respekton nivelin minimal të raportit të njaftueshmërisë së kapitalit sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje ose përcaktimeve të tjera të Bankës së Shqipërisë.

a) formularët 1 dhe 2 të aneksit 8, ndryshojnë si bashkëlidhur këtij vendimi;

b) në formularin 9 të aneksit 7, rreshti i fundit ndryshon në “Pakësimet për rritjen e portofolit brenda vendit për vitin 2016”.

2. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe Statistikave me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 janar 2016.

KRYETARI
Gent Sejko

¹ Sipas Sistemit Raportues të Unifikuar, përfshihen: “Individët”, “Njësitë tregtare dhe industriale private”, “Njësitë tregtare dhe industriale publike”, “Punonjësit e bankës” dhe “Klientë të tjerë”.

² Sipas Sistemit Raportues të Unifikuar, përfshihen: “Individët”, “Njësitë tregtare dhe industriale private”, “Njësitë tregtare dhe industriale publike”, “Punonjësit e bankës” dhe “Klientë të tjerë”.



ANEKS 8
FORMULARI I RAPORTIMIT NR. 1

Llogaritja e rritjes së totalit të aktiveve të ponderuara me rrezik, bazuar në klasat “Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare” dhe “Veprimet me letrat me vlerë” jorezidente në valutë
(në mijë lekë)
Emri i bankës
Periudha raportuese
Data e raportimit
Përgatiti (emër, mbiemër, firmë)
Drejtuesi (emër, mbiemër, firmë)

Nr.	Llogaritja e rritjes së totalit të aktiveve të ponderuara me rrezik, bazuar në klasat “Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare” dhe “Veprimet me letrat me vlerë”, të jorezidentëve në valutë	Mënyra e llogaritjes
1	Totali i zërave të aktivitetit “Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare” dhe i “Veprimeve me letrat me vlerë” të jorezidentëve në valutë, mars 2013	(a)
2	Totali i zërave të aktivitetit “Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare” dhe i “Veprimeve me letrat me vlerë”, të jorezidentëve në valutë në periudhën raportuese	(b)
3	Rritja e zërave të aktivitetit “Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare” dhe i “Veprimeve me letrat me vlerë”, të jorezidentëve në valutë	(c) = (b) - (a)
4	Totali i zërave të pasivitetit “Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare” dhe i “Veprimeve me letrat me vlerë” të jorezidentëve në valutë, mars 2013	(d)
5	Totali i zërave të pasivitetit “Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare” dhe i “Veprimeve me letrat me vlerë”, të jorezidentëve në valutë në periudhën raportuese	(e)
6	Rritja e zërave të pasivitetit “Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare” dhe i “Veprimeve me letrat me vlerë”, të jorezidentëve në valutë	(f) = (e) - (d)
7	Shtesa e totalit të aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të ponderuar me rrezik	(g) = 0 nëse (c) ≤ 0 ose (c) < (f); (g) = (c) nëse (f) < 0 (g) = (c) - (f) nëse (f) > 0

FORMULARI I RAPORTIMIT NR. 2

Nr.	Llogaritja e pakësimit të totalit të aktiveve dhe të zërave jashtë bilancit të ponderuar me rrezik, bazuar në rritjen e portofolit të kredisë bruto brenda vendit	Mënyra e llogaritjes
1	Portofoli i kredisë bruto, në dhjetor 2015	(a)
2	Portofoli i kredisë bruto, në periudhën raportuese 2016	(b)
3	Rritja e portofolit të kredisë, 2016	(c) = (b) - (a)
4	Rritja e portofolit të kredisë për 2016-n, me bazë vjetore, sipas periudhës raportuese: - nëse periudha raportuese është mars 2016 - nëse periudha raportuese është qershor 2016 - nëse periudha raportuese është shtator 2016 - nëse periudha raportuese është dhjetor 2016	(d) = (c) * 4; (d) = (c) * 2; (d) = (c) * 4/3 (d) = (c)
5.	4% e portofolit të kredisë së dhjetorit 2015	(e) = (a) * 4%
6.	10% e portofolit të kredisë së dhjetorit 2015	(f) = (a) * 10%



7.	Pakësimi i aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të ponderuar me rrezik, vetëm mars 2016 dhe për qershorin 2016	$(g) = 0$ nëse $(d) < (e)$; $(g) = (c)$ nëse $(e) < (d) < (f)$; $(g) = (f)$ nëse $(d) > (f)$
8.	Pakësimi i aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të ponderuar me rrezik, vetëm shtator 2016 dhe për dhjetorin 2016	$(g) = 0$ nëse $(d) < (e)$; $(g) = 50\% * (c)$ nëse $(e) < (d) < (f)$; $(g) = 50\% * (f)$ nëse $(d) > (f)$

VENDIM

Nr. 130, datë 31.10.2015

PËR CERTIFIKIMIN PARAPRAK TË SHOQËRISË TAP AG SI OPERATOR I PAVARUR I TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR

Bazuar në nenet 13, 37 dhe 38, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, nenin 11, pika 3, të rregullave “Për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror”, të miratuar me vendimin nr. 100, datë 5.8.2015, të Bordit të ERE-s, të ndryshuar, të pikës 4.5.2, të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar (*Final Joint Opinion*), miratuar me vendimin nr. 64, datë 13.6.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Traktatit të Komunitetit të Energjisë, të ratifikuar me ligjin nr. 9501, datë 3.4.2006, “Rregullat për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, vendimit të Këshillit Ministerial nr. D/2011/02/MC-EnC, si dhe në përputhje me Direktivën 2009/73-EC dhe Rregulloren EC nr. 715/2009, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.10.2015, pasi shqyrtoi relacionin përgatitur nga grupi i punës “Për aplikimin e bërë nga ana e kompanisë TAP AG për miratimin paraprak të certifikimit të TAP AG si Operator i Sistemit të Transmetimit të gazit natyror”, si dhe

duke marrë në konsideratë që:

- Në datën 1 korrik 2015, TAP AG ka paraqitur në ERE kërkesën nr. 12/11 prot., datë 6.7.2015, dhe dokumentacionin përkatës, i cili është, gjithashtu, i aksesueshëm edhe në *Data Room*-in e krijuar për qëllim të certifikimit si operator i pavarur i transmetimit të gazit natyror, në përputhje me pikën 4.5.2 të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar (*Final Joint Opinion*), miratuar me vendimin nr. 64, datë 13.6.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

- Kjo kërkesë dhe dokumentacioni i paraqitur në ERE, është vënë, gjithashtu, në dispozicion të autoriteteve RAE dhe AEEGSI, si pjesë e gjithë

dokumentacionit të nevojshëm për procedurën e certifikimit nga tre rregullatorët e vendeve ku kalon projekti TAP, përkatësisht Greqi, Shqipëri dhe Itali.

- Kjo kërkesë për miratim, mbështetet në sa përcaktuar në pikën 4.5.2 të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar (*Final Joint Opinion*), miratuar me vendimin nr. 64, datë 13.6.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

- Për efekt të këtij aplikimi janë depozituar dokumentet si vijon:

- aplikimi për certifikim, i cili përmban lidhjet dhe dokumentet mbështetëse të aplikimit formal;

- *Position Paper I* - drafti i aplikimit të certifikimit (konfidencial);

- *Position Paper II* - financimi (konfidencial);

- *Road Map* për TAP, për funksionimin sipas modelit ITO (konfidencial).

- Referuar nenit 37, pika 6, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, ERE ruan konfidencialitetin e informacionit tregtar.

- Komunikimin e TAP AG, datë 19 tetor 2015 (protokolluar me nr. 12/18, datë 27.10.2015, i cili përmban një kopje të Marrëveshjes së Aksionarëve të TAP-it, midis aksionarëve dhe kompanisë.

- Paragrafi 4.5 i Opinionit të Përbashkët Përfundimtar (*Final Joint Opinion*) vendos përjashtimin e TAP AG nga rregullat mbi ndarjen e pronësisë sipas nenit 9, pika 1, të Direktivës 2009/73/EC, për një periudhë 25 vjet, duke filluar nga vendosja në përdorim e infrastrukturës.

- Paragrafi 4.5 i pikës 2 të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar (*Final Joint Opinion*) kërkon që TAP AG të certifikohet si operator i pavarur i transmetimit për gazin natyror, para fillimit të ndërtimit të infrastrukturës dhe jo më vonë se data 1 janar 2018.

- Në pikën 4.5 të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar (*Final Joint Opinion*) janë përcaktuar kriteret përkatëse për certifikimin para vënies në operim të gazsjellësit.

- ERE, në cilësinë e autoritetit përgjegjës për



rregullimin e sektorit të gazit natyror dhe në përputhje me ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe me detyrimet sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë, ratifikuar me ligjin nr. 9501, datë 3.4.2006, ka miratuar me vendimin nr. 100, datë 5.8.2015, rregullat “Për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror”, të ndryshuar.

- Neni 10, paragrafi 6, i Direktivës 73/2009-EC, parashikon se autoritetet rregullatore duhet të vënë në dijeni Komisionin, për vendimin e shprehur apo të pashprehur me fjalë, për certifikimin operatorit të sistemit të transmetimit të gazit, si dhe të gjitha informacionet relevante që kanë çuar në këtë vendim. Komisioni vendos në bazë të procedurave të përcaktuara në nenin 3 të Rregullores CE 715/2009.

- Neni 11 i Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe neni 9 i vendimit të Këshillit Ministerial nr. D/2011/02/MC-EnC, parashikon që ERE duhet të vërë në dijeni Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë për vendimin e shprehur apo të pashprehur me fjalë për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të gazit natyror. Sekretariati vendos në bazë të procedurave të përcaktuara në nenin 9, pika 2, të vendimit të Këshillit Ministerial të Komunitetit të Energjisë.

- Neni 10, paragrafi 8 i Direktivës 73/2009-EC parashikon se autoritetet rregullatore dhe Komisioni Evropian duhet të garantojnë sekretin e informacioneve tregtare me karakter konfidencial, siç është parashikuar në procedurën e certifikimit.

- Nëpërmjet komunikimit të 1 korrikut 2015, i cili përmban rrethanat e certifikimit, TAP AG ka prezantuar argumentet e duhura në favor të certifikimit të tij, në cilësinë e operatorit të sistemit të transmetimit, sipas modelit ITO, parashikuar në kapitullin IV, të Direktivës 2009/73/CE, pavarësisht mospërmbushjeve të disa detyrimeve të parashikuara në këtë model.

- Në këtë komunikim, shoqëria TAP AG ka evidentuar, se është një shoqëri posaçërisht e ngritur për ndërtimin e gazsjellësit TAP, pa asnjë interes direkt apo indirekt në aktivitetet e prodhimit apo të furnizimit dhe e ndarë nga aksionarët e saj. Rrjedhimisht, TAP AG nuk është një sipërmarrje vertikalisht e integruar, siç parashikohet në artikullin 2, paragrafi 22, i Direktivës 2009/73/CE.

- Me vendimin nr. 101, datë 5.8.2015, ERE ka hapur procedurën për shqyrtimin e aplikimit të

shoqërisë TAP AG, për certifikim si operator i pavarur i transmetimit të gazit natyror.

- Në lidhje me aplikimin e bërë nga shoqëria TAP AG për certifikim, ERE ka nisur aktivitetet e nevojshme të bashkëpunimit me RAE dhe AEEGSI, për të finalizuar adaptimin e një vendimi të përbashkët për TAP AG, sipas modelit ITO, i cili është në përputhje me kapitullin IV të Direktivës 2009/73/CE, dhe e përjashtuar nga artikulli 22 i Direktivës, ashtu si parashikohet në paragrafin 4.5, pika 2, e *Final Joint Opinion*.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin paraprak të certifikimit të shoqërisë TAP AG, si Operator i Pavarur i Transmetimit të Gazit Natyror, në përputhje me nenin 10 të Direktivës 2009/73/CE dhe të paragrafit 4.5.2, të *Final Joint Opinion*, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi (aneks A), i rënë dakord me RAE dhe AEEGSI, i cila është pjesë integrale e vendimit.

2. Të përcjellë këtë vendim Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për opinion, ashtu si përcaktohet në nenin 3 të rregullores nr. 715/2009-EC dhe nenin 9, pika 1, të vendimit të Këshillit Ministerial të Komunitetit të Energjisë nr. D/2011/02/MC-EnC.

3. Të përcjellë këtë vendim Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes, Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Autoritetit të Konkurrencës, RAE, AEEGSI dhe shoqërisë TAP AG.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 136, datë 26.11.2015

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË RREGULLAT E TREGUT SHQIPTAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 99, 109, pikat 4 dhe 5; 110, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenit 26, të “Rregullave të praktikës dhe proce-



durave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator i Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.11.2015, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut, në lidhje me një ndryshim në “Rregullat e tregut të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 68, datë 23.6.2008, të ndryshuar,

konstatoi se:

- ERE ka detyrimin e përafrimit të kuadrit ligjor ekzistues me parashikimet e ligjit nr. 43/2015, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

- Organi i administratës në ushtrimin e funksioneve të tij e në zbatim të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, duhet të respektojë parimin e drejtësisë, barazisë dhe të proporcionalitetit.

- Në nenin 99, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, parashikohet se: “Çdo pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike është përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e një ndryshimi në kapitullin IX.1.3, germa “g”, të “Rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike”, me përmbajtjen si më poshtë:

“Duke filluar nga 1 janari 2016, çdo pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike është përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike, sipas legjislacionit në fuqi”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a., KESH sh.a. dhe OST sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 137, datë 26.11.2015

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “PHOENIX PETROLEUM” SHA, NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të nenit 22, pika 2, germa “c”, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe neneve 4, pika 1, germa “c”; 8; 9, pikat 1 dhe 2, germa “f” dhe nenin 10, pika 1, të “Rregullave dhe procedurave për licencimin, ndryshimin, transferimin e pjesshëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror”, Bordi i Entit Rregullator i Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.11.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Phoenix Petroleum” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, për licencimin në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Phoenix Petroleum” sh.a.,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Phoenix Petroleum” sh.a., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregullat dhe procedurat për licencimin, ndryshimin, transferimin e pjesshëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror”, si më poshtë:

- Formatit dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 1, germa d/i, d/ii, d/v, d/vi) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale (neni 9, pika 1, germa e/i, e/ii, e/iii, e/v, e/vi) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumente specifike për llojin e licencës (neni 9, pika 2, germa f/i) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- nenin 9, pika 2, germa f/ii (mbi garancinë që cilësia e furnizimit të gaz të përmbushë kriteret minimale të operatorit të sistemit);

- nenin 9, pika 1, germa d/v (dokumentacioni që tregon titujt e pronësisë mbi asetet që ka);



- nenin 9, pika 2, germa f/iii (kapitalin financiar dhe mbështetja financiare e nevojshme për kryerjen e aktivitetit),

do të njoftohet subjekti, që në bazë të “Rregullave dhe procedurave për licencimin, ndryshimin, transferimin e pjesëshëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror”, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Phoenix Petroleum” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror.

2. Drejtoria e Licencimit, e Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 138, datë 26.11.2015

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HP UJANIKU ENERGY” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGISË ELEKTRIKE NGA HEC “UJANIK 2”, ME FUQI TË INSTALUAR 2500 kW

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “a” dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 13, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Entit Rregullator i Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.11.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HP Ujaniku Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga HEC “Ujanik 2”,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “HP Ujaniku Energy”

sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “HP Ujaniku Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Ujaniku 2”, me fuqi të instaluar 2500 kW.

2. Drejtoria e Licencimit, e Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 139, datë 26.11.2015

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HP UJANIKU ENERGY” SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d” dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 2; 13, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Entit Rregullator i Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.11.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HP Ujaniku Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, të Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve dhe



Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, për licencimin në aktivitetin e tregutit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “HP Ujaniku Energy” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Të dhënat specifike sipas tipit të licencës (neni 9, pika 4/10, germat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “HP Ujaniku Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregutit të energjisë elektrike, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, e Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s

Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 140, datë 26.11.2015

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ENERGJIA D.O.O. VETERNIK” SHPK,
NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d” dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 2; 13, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Entit Rregullator i Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës

Faqe | 14370

26.11.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Energjia D.O.O. Veternik” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, të Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, për licencimin në aktivitetin e tregutit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Energjia D.O.O. Veternik” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE, në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Të dhënat specifike sipas tipit të licencës (neni 9, pika 4/10, germat “a”, “b” dhe “c”) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Energjia D.O.O. Veternik” sh.p.k., në aktivitetin e tregutit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, e Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s

Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 141, datë 26.11.2015

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ENERGJIA D.O.O. VETERNIK” SHPK
NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “ç”; 39, pika 3 dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “f”; 5, pika 1, germa “p”; 13, të rregullores



“Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Entit Rregullator i Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.11.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Energjia D.O.O. Veternik” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, për licencimin në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Energjia D.O.O. Veternik” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizuesit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/9, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Energjia D.O.O. Veternik” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, e Monitorimit të Tregut dhe të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 142, datë 26.11.2015

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “C & S ENERGY” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “RAPUN 3 & 4”, ME FUQI TË INSTALUAR 8857 kW

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “a”; 39, pika 4, dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 13, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Entit Rregullator i Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.11.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “C & S Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga HEC “Rapun 3 & 4”,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “C & S Energy” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4 dhe 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3), rezulton se vërtetimi nga tatim-taksat është në proces apelimi.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “C & S Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë



elektrike nga HEC “Rapuni 3 & 4”, me fuqi të instaluar 8857 kW, për një afat 30-vjeçar, me kusht që të paraqesë në ERE brenda 45 ditëve, vërtetimin përfundimtar të likuidimit të tatim-taksave.

2. Me plotësimin e afatit 45-ditor, të sipërcituar, ky vendim do të jetë objekt rishikimi nga Bordi i ERE-s.

3. Drejtoria e Licencimit, e Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 143, datë 26.11.2015

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “C & S ENERGY” SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d”; 39, pika 4, dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 2; 13, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Entit Rregullator i Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.11.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “C & S Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, të Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “C & S Energy” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Të dhënat specifike sipas tipit të licencës (neni 9, pika 4/10, germat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3), rezulton se vërtetimi nga tatim-taksat është në proces apelimi.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë “C & S Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 30-vjeçar, me kusht që të paraqesë në ERE menjëherë sapo të marrë vërtetimin përfundimtar të likuidimit të tatim-taksave.

2. Me plotësimin e afatit 45-ditor të sipërcituar, ky vendim do të jetë objekt rishikimi nga Bordi i ERE-s.

3. Drejtoria e Licencimit, e Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 145, datë 26.11.2015

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË GSA SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 57, DATË 22.6.2011

Në mbështetje të neneve 16; 20, germa “b”, 37, germa “d”, dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “g”; 10, pikat 1 dhe 3, dhe nenit 16, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me



vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.11.2015, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “GSA” sh.p.k., për rinovimin e licencës në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike dhe relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “GSA” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Të dhënat specifike sipas tipit të licencës (neni 9, pika 4/10, germa “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “GSA” sh.p.k. për rinovimin e licencës në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 57, datë 22.6.2011.

2. Drejtoria e Licencimit, e Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 146, datë 26.11.2015

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “LIRIA ENERGJI” SHPK, NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “SHPELLA POSHTË 2”, ME FUQI TË INSTALUAR 2300 kW

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “a” dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 10, pika 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pika 1, germa “a”, e “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator i Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.11.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Liria Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga HEC “Shpella Poshtë 2”,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Liria Energji” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3, 4.1.4 dhe 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Liria Energji” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Shpella Poshtë 2”, me fuqi të instaluar 2300 kW.

2. Drejtoria e Licencimit, e Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 147, datë 26.11.2015

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “LIRIA
ENERGJI” SHPK, NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d” dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 2; 10, pikat 1 dhe 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pika 1, germa “a”, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator i Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.11.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Liria Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, të Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Liria Energji ” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe

pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Të dhënat specifike sipas tipit të licencës (neni 9, pika 4/10, germat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin shoqërisë “Liria Energji” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, e Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuarin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 148, datë 26.11.2015

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “LIRIA
ENERGJI” SHPK, NË AKTIVITETIN E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “ç” dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “f”; 5, pika 1, germa “p”; 10, pika 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pika 1, germa “a”, “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator i Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.11.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Liria Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, të Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, për licencimin në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,



konstatohet se:

Aplikimi i shoqërisë “Liria Energji” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionit financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Liria Energji” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, e Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s

Petrit Ahmeti

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin numër 62-2015-5083(1517), datë 18.11.2015, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Florenc Nito, i biri i Llukanit dhe i Gonasë, i datëlindjes 9.12.1989, që nga data 27.9.2010, si dhe caktimin me cilësinë e kujdestarit për administrimin e pasurisë së tij, babanë, shtetasin Llukan Nito, i datëlindjes 1.6.1951, i biri i Zoit dhe i Uranisë.

KËRKESË

Shtetasja Tefta Hodaj, e bija e Imerit dhe e Kaleses, e datëlindjes 5.10.1948, e lindur në fshatin Kuc, Komuna Hore, Vranisht, banuese në Vlorë kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, shpalljen të zhdukur dhe të vdekur të bashkëshortit të saj, shtetasit Mehmet Hodaj, i datëlindjes 12.2.1942, i biri i Shaqos dhe i Zonjes, lindur në Karbunare, Komuna Armen.

KËRKUESE

Tefta Hodaj

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 140 lekë